



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:039801
Datë: 05.08.2022
Numri i dokumentit: 03303498

PPP.nr.12/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit A...I me seli në L. dhe me numër të biznesit ..., kundër debitorit K... I...t Rr. ... Istog, për shkak të borxhit në shumë prej 3,484.64€, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt: 08.02.2022 kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.05.08.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tersi si i pabazuar prapësimi i debitorit K... I...t Rr. ... Istog, ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarim P.nr.51/2022 të dt. 28.01.2022, sipas propozimit të kreditorit A...I me seli në L. dhe me numër të biznesit

A r s y e t i m

Kreditori, A...I me seli në L. dhe me numër të biznesit ..., ka ushtruar propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, ndaj debitorit K... I...t Rr. ... Istog, duke kërkuar që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet debitori pagesën e borxhit në shumë prej 3,484.64€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore të gjitha në afat 7 ditor nga dita e pranimit të propozimit, në të kundërtën ti bllokoj të gjitha llogarit bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjetet monetare në llogari të bëhet sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme dhe mjetet e mbledhura të barten në llogari të përmbaruesit privat, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim te datës 28.01.2022.

Përmbaruesi privat, me urdhrin P.nr.51/2022 të dt. 28.01.2022, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, K... I...t Rr. ... Istog brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrorit përmbarimor, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin urdhër ta hedhë

si të pa rregullt ose të njëjtin të refuzoj si të pa bazuar, me arsyetimin se propozimit i është bashkangjitur fatura me numër 92-210-001-20 në kopje të pavërtetuar, dhe të pa pranuar nga ana e debitorit, po ashtu fatura nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 40 par.1 dhe 2 të LPP-së. Më tutje ka shtuar se kreditori edhe për kundër faktit se nuk e ka përmbushur kontratën debitorit i ka faturuar si borxh për punët e pa kryera ku në bazë të raportit të komisionit ka konstatuar se punë kryerësi ka betonuar 900 m gjatësi të kanalit nga 1100 m të paraparë sipas kontratës.

Pas ngritjes së prapësimit nga debitori, kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me propozim që të refuzohet në tersi prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor me arsyetimin se kreditori duke u mbështetur në dispozitat e LPP-së ka iniciuar procedurën përmbarimore në bazë të dokumentit të besueshme- faturës, e cila faturë në original si dhe në kopje dhe është e pranuar nga ana e debitorit, ashtu që pretendimet e debitorit janë të pa bazuara dhe nuk ka ofruar asnjë provë, e duke vepruar në kundërshtim me nenin 69 par.4 dhe 71 të LPP-së.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pabazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të provave tjera në shkresat e lëndës, si dhe pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar lidhur me atë se propozimit i është bashkangjitur fatura me nr. 92-210-001-20 në kopje të pavërtetuar dhe të pa pranuar, po ashtu fatura nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 40 par.1 dhe 2 të LPP-së, pretendimet e lartcekura i refuzoj si të pa bazuara pasi që fatura me nr. 92-210-001-20 me të cilën është lejuar përmbarimi, është në original konform nenit 37 të LPP-së, po ashtu e njëjta faturë i përmban të gjitha elementet siç kërkohej me nenin 29 par.1.3 dhe par.3 e në lidhje me nenin 38 par.1 dhe 2 të LPP-së siç janë të dhënat për kreditorin, debitorin, nr. e faturës, datën e lëshimit, afatin e pagesës, përshkrimin, sasinë, njësinë, çmimin pa TVSH, zbritjen, TVSH, vlerën totalin për pagës, nënshkrimin e lëshuesit, e e cila faturë është e pranuar nga ana e debitorit.

Kurse sa i përket pretendimeve të debitorit lidhur me atë se kreditori edhe për kundër faktit se nuk e ka përmbushur kontratën debitorit i ka faturuar si borxh për punët e pa kryera ku në bazë të raportit të komisionit ka konstatuar se punë kryerësi ka betonuar 900 m gjatësi të kanalit nga 1100 m të paraparë sipas kontratës, lidhur me pretendimet e lartcekura gjykata sqaron faktin se

ne procedurë përmbarimore vetëm ekzekutohet dokumenti përmbarimor ose i besueshëm nëse plotësohen kushtet ligjore të parapara sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore, dhe nuk mund të lëshohet në vlerësimin e pretendimeve se a është kryer një punë e caktuar apo jo, për më tepër vërtetimi i pretendimeve të lartcekura mund të bëhet në ndonjë procedurë tjetër, e jo në procedurë përmbarimore.

Se debitori i obligohet kreditorit si në propozim për përmbarim këtë fakt gjykata e mbështetë në nenin 245 par.1 të LMD-së i cili nen parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.3 dhe par.3, 37, 38, 40, 69, 71 e 73 par. 3, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.12/2022, dt.05.08.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.